

**AKT THEMELIMI**  
**SHOQËRIA TREGTARE**  
**“WINWINDEAL” SH.P.K**

Sot ne Tirane, më datë 21 /06/2022, Ne,

**Eljo ELEZI**, atësia Luan, lindur në Tiranë dhe me banim në Rr. "Medar Shtylla", Nd.6, H. 1, Ap.31, Nj.A.Nr.5, 1019, Tiranë, i datëlindjes 30.05.1987, i identifikuar nëpërmjet Letërnjoftimit ID Nr. 033927729 dhe Nr.Personal: I70530070W, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar dhe me gjendje civile i martuar,

**Aneld KËNDEZI**, atësia Skënder, lindur në Sarandë dhe me banim në Rr. "Robert Shvarc" Nd.3, H. 1, Ap.22, Nj.A.Nr.5, 1019, Tiranë, i datëlindjes 22.12.1987, i identifikuar nëpërmjet Letërnjoftimit ID Nr. 033997919 dhe Nr.Personal: I71222081N, madhor dhe me zotësi të plotë për të vepruar, me gjendje civile beqar, dhe

**Ervis KULLA**, atësia Kujtim, lindur në Sarandë dhe me banim në "Ibrahim Dervishi" Nd.23, H. 5, Ap.15, Nj.A.Nr.5, 1019, Tiranë, i datëlindjes 02.01.1988, i identifikuar nëpërmjet Letërnjoftimit ID Nr. 033997599 dhe Nr.Personal: I80102088L, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar dhe me gjendje civile i martuar, me dëshirë të lirë dhe me vullnet të plotë e të pavesuar deklarojmë se kemi hartuar aktin e themelimit të shoqërisë **“WINWINDEAL” SH.P.K.** bazuar në Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë, ligjit Nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” i ndryshuar, Ligjit Nr. 9723, datë 03.05.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit” i ndryshuar, Ligjit Nr.131/2015 “Për Qendrën Kombëtare të Biznesit” të cilin e nënshkruajmë

**NENI 1 FORMA E SHOQËRISË**

Formohet një shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar (**SH.P.K**), që ushtron aktivitetin e saj sipas objektit në përputhje me Legjislacionin Shqiptar në fuqi, dhe në veçanti por jo ekskluzivisht vetëm me Ligjin Nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” i ndryshuar, me ligjin Nr. 9723, datë 03.05.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit” të ndryshuar, Ligjin Nr.131/2015 “Për Qendrën Kombëtare të Biznesit”, si dhe me përcaktimet e këtij akt themelimi dhe statuti.

**NENI 2 EMRI I SHOQËRISË**

Emri i shoqërisë është **“WINWINDEAL” Sh.p.k.** Shoqëria do të përdorë edhe vulën e saj në të gjitha korrespondencat dhe/ose në të gjitha dokumentet e saj e cila do të përbëhet minimalisht nga emri i shoqërisë dhe nga NIPT dhe nga çdo karakteristikë tjetër e nevojshme për shoqërinë në komunikim me palë të treta. Themeluesit kanë zgjidhur emrin e shoqërisë në marrëveshje me

njëri tjetrin dhe ky emër nuk është i regjistruar apo të jetë bllokuar apo regjistruar etj., përgjegjësi të cilat i marrin përsipër vetëm.

### NENI 3 ORTAKËT E SHOQËRISË

Shoqëria **“WINWINDEAL” Sh.p.k.** krijohet dhe themelohet si shoqëri me përgjegjësi të kufizuar me 3 (tre) ortak. Ortakët e shoqërisë shoqërisë **“WINWINDEAL” Sh.p.k.** janë si më poshtë vijon:

1. **Eljo ELEZI**, i biri i Luan dhe Idiana, lindur në Tiranë dhe me banim në Rr. "Medar Shtylla", Nd.6, H. 1, Ap.31, Nj.A.Nr.5, 1019, Tiranë, i datëlindjes 30.05.1987, i identifikuar nëpërmjet Letërnjoftimit ID Nr. 033927729 dhe Nr.Personal: I70530070W, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar dhe me gjendje civile i martuar,
2. **Aneld KËNDEZI**, i biri i Skënder dhe Zhuljeta, lindur në Sarandë dhe me banim në Rr. "Robert Shvarc" Nd.3, H. 1, Ap.22, Nj.A.Nr.5, 1019, Tiranë, i datëlindjes 22.12.1987, i identifikuar nëpërmjet Letërnjoftimit ID Nr. 033997919 dhe Nr.Personal: I71222081N, madhor dhe me zotësi të plotë për të vepruar, me gjendje civile beqar, dhe
3. **Ervis KULLA**, i biri i Kujtim dhe Vjollca, lindur në Sarandë dhe me banim në "Ibrahim Dervishi" Nd.23, H. 5, Ap.15, Nj.A.Nr.5, 1019, Tiranë, i datëlindjes 02.01.1988, i identifikuar nëpërmjet Letërnjoftimit ID Nr. 033997599 dhe Nr.Personal: I80102088L, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar dhe me gjendje civile i martuar,

Nëse shoqëria mbetet me një ortak, atëhere ortaku i vetëm detyrohet ta regjistrojë këtë fakt, sipas nenit 43 të ligjit Nr. 9723, datë 3.5.2007, “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit” i ndryshuar. Nëse ortaku i mbetur nuk përmbush këtë detyrim, atëhere ortaku përgjigjet personalisht për detyrimet që shoqëria merr përsiper nga data në të cilën duhet të ishte kryer regjistrimi, sipas këtij neni, deri në datën në të cilën ky regjistrim u krye efektivisht.

### NENI 4 SELIA E SHOQËRISË

Selia e shoqërisë **“WINWINDEAL” Sh.p.k.** ndodhet me adresë: **“Bulevardi Gjergj Fishta, Nd.32, H.14, Ap.60, Njësia Administrative Nr.7, 1001, Tiranë”**. Trasferimi i selisë së shoqërisë në një tjetër adresë bëhet me vendim të Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve dhe sipas procedurave ligjore dhe/ose nënligjore në fuqi për këtë qëllim duke bërë regjistrimin pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit si dhe duke bërë njoftimet e tjera sipas legjislacionit në fuqi (administratën tatimore qendrore dhe vendore). Shoqëria mund të vendos të hapi brenda dhe jashtë vendit, degë dhe/ose zyra përfaqësimit sipas procedurave ligjore dhe/ose nënligjore në fuqi duke bërë regjistrimet e nevojshme sipas legjislacionit shqiptarë dhe/ose të huaj në fuqi për këtë qëllim.

Page 2 of 8

## NENI 5 OBJEKTI / VEPRIMTARIA TREGTARE E SHOQËRISË

Shoqëria "WINWINDEAL" Sh.p.k. ka si objekt të veprimtarisë tregtare së saj, por pa u kufizuar, si vijon: "Veprimtari ekonomike ne fushen e real estate (pasurive te paluajtshme), qe ka te bej me negocime, ndermjetesime, perfaqesime te te treteve ne fushen e real estate si ne tregun e brendshem ashtu edhe ne ate nderkombetar. Shitje, blerje, dhenie me qira te te gjitha llojeve te pasurive te paluajtshme, brenda dhe jashte vendit, si dhe cdo transakcion tjetër ne funksion te permbushjes se objektit te veprimtarise ne fushen e real estate, midis personave fizike, personave juridike private dhe publike si dhe nga shteti si dhe cdo veprim tjetër i ligjshem qe ka te beje me pasurite e paluajtshme. Veprimtari ekonomike ne fushe e turizmit, nepermjet ngritjes, operimit dhe adminstrimit te strukturave turistike pritese (akomoduese) dhe te gjitha sherbimet direkt apo indirekt te lidhura me to, si ne tregun e brendshem ashtu edhe ne ate nderkombetar; Marrja dhe/ose zhvillimi, kryerja ose ofrimi i sherbimeve ne fushe e real estate (pasurive te paluajtshme), qe kane te bejne me marketing, marredhenieve me publikun, ekspertize shitje apo qiradhenie apo operim/administrim turistik, menaxhimi, sherbime te studimit te tregut, sherbime te pas shitjes, ndjekja e pagesave te klienteve. Vleresimi i te gjitha llojeve te pasurive te paluajtshme (urbane, rurale, komerciale, adminitrative, shoqerore, turistike, rezidenciale etj.) dhe asetete (te luajtshme apo te paluajtshme) ne funksionte tyre; Administrimi i bashkepronesisë ne ndertesa, ne resorte apo struktura turistike dhe ne komplekse rezidenciale. Krijimi i faqeve web, platformave elektronike ne internet dhe aplikacioneve me synim zhvillimin e aktivitetit te shoqerise edhe nepermjet pajisjeve elektronike te komunikimit ne distance. Shoqeria mund edhe te jape garanci reale dhe/ose personale, te vendose pengje, te dale dorezanese apo te vendose hipoteke edhe ne favor te te treteve.

Projektme dhe studime urbanistike: projektme e ndertime civile, industriale turistike, bujqesore: studime ambjentale dhe vleresim te ndikimit ne Mjedis: projektme interieresh: Projektim Peisazhi e sistemimi: studime e projektme hidrogjeologjike dhe gjeologjike: projektme Rrugesh, Urash, Porte turistike: projektme te inxhinjerise elektrike, te inxhinjerise hidro-mekanike: projektme konstruktive dhe supervizion punimesh: restaurime. Si dhe konsulenca per temat e me siperme, perfshire dhe perfaqesimin/aplikimet on-line ne institucionet shteterore nepermjet platformave qeveritare.

Sherbime Avokatie, konsulence ligjore dhe asistence per cdo natyre ceshtje ligjore, ne vecanti ato te pronave dhe te ndertim zhivllimit te tyre. Hartim i dokumentacionit ligjor, ndjekie dhe administrim i kontratave. Përfaqesim i personave fizike e juridike ne cdo institucion, perfshire dhe perfaqesimin/aplikimet on-line ne institucionet shteterore nepermjet platformave qeveritare."

Për realizimin e objektit të veprimtarisë së saj shoqëria mund gjithashtu të blejë dhe të shesë pasuri të luajtshme dhe/ose të paluajtshme, të kryejë çdo lloj operacioni financiar aktiv e pasiv, të ndërmarrë e të zhvillojë çdo lloj aktiviteti industrial, tregtar, që konsiderohen të dobisheme dhe të përshtatshme si dhe fitimprurëse për shoqërisë në përputhje me legjislacionin shqiptarë në fuqi dhe/ose me legjislacionin e huaj për këtë qëllim. Shoqëria dhe sipas interesit të ortakut

dhe/ose ortakëve të saj mund të ushtroje aktivitet tregtar fitimprurës të tjera nga ajo e përcaktuar në këtë nen, duke respektuar paraprakisht çdo kërkesë ligjore dhe/ose nënligjore në fuqi për këtë qëllim. Për aktivitet e përmendura më sipër shoqëria (si dhe ato të papërmendura dhe të lejuara në bazë të legjislacionit në fuqi) mund ti kryej në sektorin publik, të administratës publike në përgjithësi si dhe në sektorin privat. Aktivitete të tilla mund të kryhen nga shoqëria si drejtpërdrejtë dhe nëpërmjet subjekteve të treta me qëllimet e dhëna ose pjesëmarrëse ose të kontrolluar. Shoqëria me vendim të Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve, në bazë të dispozitave të aktit të themelimit, statutit dhe në përputhje me ligjin/legjislacionin në fuqi, mund të marri drejtpërdrejtë ose indirekt interesa ose pjesëmarrje, duke përfshirë edhe ato aksionare, në shoqëri dhe/ose në ndërmarrje të ndryshme në Shqipëri dhe/ose në vende të tjera jashtë Shqipërisë, që kanë objekt të ngjashëm, të njëjtë ose kanë lidhje me objektin e saj ose me qëllim fitimprurës për shoqërinë. **Shoqëria nuk ka për të kryer asnjë aktivitet pa marrë paraprakisht licencat apo lejet e nevojshme sipas legjislacionit shqiptarë në fuqi apo legjislacionit të shteteve të huaja ku mund të ushtrojë aktivitetin e saj.**

## NENI 6 KOHËZGJATJA E SHOQËRISË

Kohëzgjatja e aktivitetit/veprimtarisë të shoqërisë “WINWINDEAL” Sh.p.k. është e pakufizuar. Kohëzgjatja e aktivitetit/veprimtarisë të shoqërisë fillon nga data e regjistrimit në regjistrin tregëtar të Qendrës Kombëtare të Regjistrimit (QKR) / Biznesit (QKB) dhe nëse kërkohet nga ligji mbas marrjes së licencave përkatëse për ushtrimin e aktivitetit tregtar.

## NENI 7 KAPITALI I SHOQËRISË

Kapitali bazë fillestar i shoqërisë “WINWINDEAL” Sh.p.k. është **100’000 (njëqindmijë) lekë** dhe dekalohet tërësisht i paguar nga ortakët e shoqërisë sipas pjesëmarrjes në kapital e shoqërisë.


Kontributi i ortakëve përbëjnë kapitalin themletarë dhe të regjistruar të shoqërisë “WINWINDEAL” Sh.p.k. Kapitali shoqërisë “WINWINDEAL” Sh.p.k. përbëhet nga 3 (tre) kuota të cilat kanë vlerën dhe përfaqësojnë 100 % kapitalin e shoqërisë.

Kapitali i shoqërisë “WINWINDEAL” Sh.p.k. përbëhet nga 3 (tre) kuota si më poshtë vijon:

- Z. Eljo ELEZI**, zotëron Kuotën e I e cila përfaqëson 34 (tridhjetë e kater) % të kapitalit të shoqërisë;
- Z. Aneld KËNDEZI** zotëron Kuotën e II e cila përfaqëson 33 (tridhjetë e tre) % të kapitalit të shoqërisë;
- Z. Ervis KULLA** zotëron Kuotën e III e cila përfaqëson 33 (tridhjetë e tre) % të kapitalit të shoqërisë;

## NENI 8 KONTRIBUTET NË KAPITALIN BAZË / FILLESTAR TË SHOQËRISË

Kapitali bazë përbëhet nga kontributi i ortakëve si vijon:



1. **Z. Eljo ELEZI**, kontribon në kapitalin e shoqërisë 34 % duke zotëruar 34 % të kapitalin e shoqërisë **“WINWINDEAL” Sh.p.k.** ose duke zotëruar Kuotën e I e cila përfaqëson 34 % të kapitalit të shoqërisë me të gjitha të drejtat dhe detyrimet e saj sipas legjislacionit në fuqi.
2. **Z. Aneld KËNDEZI**, kontribon në kapitalin e shoqërisë 33 % duke zotëruar 33 % të kapitalin e shoqërisë **“WINWINDEAL” Sh.p.k.** ose duke zotëruar Kuotën e II e cila përfaqëson 33 % të kapitalit të shoqërisë me të gjitha të drejtat dhe detyrimet e saj.
3. **Z. Ervis KULLA**, kontribon në kapitalin e shoqërisë 33 % duke zotëruar 33 % të kapitalin e shoqërisë **“WINWINDEAL” Sh.p.k.** ose duke zotëruar Kuotën e III e cila përfaqëson 33 % të kapitalit të shoqërisë me të gjitha të drejtat dhe detyrimet e saj.

Shoqëria mund të lëshojë një certifikatë e cila provon zotërimin e kuotave të kapitalit nga ortakët e saj sipas dispozitave ligjore në fuqi për këtë qëllim. Administratori dhe sipas nevojës mund të marrë vërtetim mbi statusin e kuotave të shoqërisë pranë Regjistrat të Barrave të Sigurimit (RBS) dhe/ose çdo institucion tjetër kompetent për këtë qëllim sipas dhe në përputhje me ligjin në fuqi për këtë qëllim. Çertifikata e lëshuar neni në emër të personit ose personave që zotërojnë kuotat në këtë shoqëri nuk mund të konsiderohet titull/letër me vlerë dhe/ose të vendoset si garanci. Të gjithë pjesët që formojnë kapitalin themeltar, nënshkruhen, shlyhen plotësisht, nga ortakët e shoqërisë **“WINWINDEAL” Sh.p.k.**

## NENI 9 ORGANET DREJTUESE TË SHOQËRISË

**Organet e shoqërisë “WINWINDEAL” Sh.p.k. janë si më poshtë vijon:**

Asambleja e Përgjithshme;  
Adminstratori/ët.

## NENI 10 ADMINISTRIMI I SHOQËRISË

Shoqëria “WINWINDEAL” Sh.p.k. administrohet nga administratori i saj **Z. Eljo ELEZI**, i biri i Luan dhe Idiana, lindur në Tiranë dhe me banim në Rr. "Medar Shtylla", Nd.6, H. 1, Ap.31, Nj.A.Nr.5, 1019, Tiranë, i datëlindjes 30.05.1987, i identifikuar nëpërmjet Letërnjoftimit ID Nr. 033927729 dhe Nr.Personal: I70530070W, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar dhe me gjendje civile i martuar, i cili ka afatin maksimal të adminsitrorit të shoqërisë që parashikon legjislacioni tregtar Shqiptar.

Shoqëria “WINWINDEAL” Sh.p.k. dhe pas krijimit të saj dhe fitimit të personaliteti juridike do të miratoj shpërblimin e administratorit si dhe kontratën e punës.

Shoqëria mund të ketë më shumë se një administrator kur vendoset nga Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve të shoqërisë “WINWINDEAL” Sh.p.k. dhe regjistrohet si i tillë pranë QKB. Shpërblimi i administratorit duhet të jetë i përshtatshëm dhe në përputhje me detyrat e administratorëve dhe gjendjen financiare të shoqërisë. Nëse shoqëria është në vështirësi financiare, Ortaku i vetëm ose Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve mund të vendosë reduktimin e shpërblimit të dministratorëve

në masën e përshtatshme. Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve mund të shkarkojë administratorin në çdo kohë me shumicë të zakonshme. Afati i emërimit të administratorit është ai afat maksimal që parashkikon legjislacioni Shqiptar në fuqi me të drejtë ripërtëritjeje, me përjashtim të rasteve të dorëheqjes ose të pushimit të papritur. Kontrata e punës së administratorit dhe kur administratori është i ndryshëm nga ortaku i shoqërisë duhet të miratohet nga Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve menjëherë pas fitimit të personalitetit juridik. **Administratori ka të drejta dhe detyrime në përputhje me ligjin Nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” i ndryshuar dhe si më poshtë vijon:**

- a) Të kryejë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme;
- b) Të përfaqësojë shoqërinë tregtare;
- c) Të kujdeset për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
- d) Të përgatitë dhe nënshkruan bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përpara asamblesë së përgjithshme për miratim;
- e) Të krijojë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
- f) Të kryejë regjistrimet dhe dërgojnë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit;
- g) Të raportojë përpara asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;
- h) Të kryejë detyra të tjera që i caktohen nga Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve.
- i) Të informojë Asamblesën e Përgjithshme mbi ndryshimet ligjore që kanë lidhje me aktivitetin tregtarë të shoqërisë si dhe me aktet bazë të shoqërisë ti till si por jo vetëm statuti si dhe akti i themelimit.
- j) Të propozojë përmirësime dhe/ose përshtatje me legjislacionin shqiptarë në fuqi të aktit të themelimit si dhe të statutit të shoqërisë.
- k) Të realizojë detyrat sipërcituar në masën dhe në përputhje me kufizimet e caktuara në aktin e themelimit dhe statutin e shoqërisë.

**Bazuar në nenin 96, të Ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, Administratori ka këto kufizime në të drejtat e veprimit për çështjet e më poshtme:**

- a) Administratori i shoqërisë nuk ka të drejtë të nënshkruajë dhe ndërmarrë asnjë lloj veprimi ose operacioni shitblerjeje i vetëm. Administratori i shoqërisë do të kryej këto veprime sëpaku me njërin prej ortakeve të shoqërisë, i ndryshëm nga administratori.
- b) Administratori i shoqërisë nuk ka të drejtë të nënshkruajë i vetëm asnjë lloj huaje, kredi, discaunts dhe cdo ofrim fondesh, që përbën një kredi ose debi për shoqërinë. Administratori i shoqërisë do të kryej këto veprime sëpaku me njërin prej ortakeve të shoqërisë, i ndryshëm nga administratori.
- c) Administratori i shoqërisë për cdo transaksion bankar mbi 5000 Euro (pesëmijë Euro) do të veprojë duke nënshkruar sëpaku me njërin prej ortakeve të shoqërisë, i ndryshëm nga administratori.

- d) Administratori i shoqërisë nuk ka të drejtë të nënshkruaje asnjë lloj akti ligjor, kontratë, marrëveshje, deklaratë të cdo lloji që do të ketë lidhje me asetet e shoqërisë. Për cdo lloj akti ligjor, që do të ketë lidhje me asetet e shoqërisë, administratori i shoqërisë do të veprojë vetëm në bazë të një Vendimi të Asamblesë së Ortakëve të Shoqërisë.
- e) Administratori i shoqërisë, nuk ka të drejtë për të hyrë në transaksione, të nënshkruajë asnjë lloj akti ligjor apo për të ekzekutuar ndonje akt, që përfshin pasuri të luajtshme apo të paluajtshme të Shoqërisë, pavaresisht nga vlera e transaksionit apo e aktit. Për cdo rast të tillë, administratori i shoqërisë do të veprojë vetëm në bazë të një Vendimi të Asamblesë së Ortakëve të Shoqërisë.
- f) Administratori i shoqërisë nuk ka të drejtë për të ndarë, tjetërsuar apo për të transferuar cdo pasuri apo biznes të shoqërisë. Për cdo rast të tillë, administratori i shoqërisë do të veprojë vetëm në bazë të një Vendimi të Asamblesë së Ortakëve të Shoqërisë.
- g) Administratori i shoqërisë nuk ka të drejtë për cdo operacion, transaksion, kërkesë, aplikim dhe/ose aktivitet tjetër, që lidhet në përgjithësi për markat, apo të drejtat e tjera të pronësive intelektuale të shoqërisë. Për cdo rast të tillë, administratori i shoqërisë do të veprojë vetëm në bazë të një Vendimi të Asamblese së Ortakëve të Shoqërisë.
- h) Në kufizimet e mësipërme nuk përfshihen e drejta për lidhjen e kontratave që kanë për objekt dhe qëllim fitimin e komisioneve nga shitjet dhe qirate. Kufizimet e mësipërme nuk janë të aplikueshme për cdo transaksion që ka për qëllim pagesat e detyrueshme të lidhura me administrimin e zakonshëm të aktivitetit të Shoqërisë duke përfshirë por pa u kufizuar në pagesën e taksave, tarifave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, pagat e punëmarrësve, detyrimet për furnitorët e energjisë elektrike dhe ujit, gjobat dhe penalitetet që lidhen me to, të cilat Administratori mund t'i autorizojë dhe kryejë i vetëm.

Administratori, gjatë kryerjes së detyrave, përgjigjet ndaj shoqërisë për çdo veprim ose mosveprim, që lidhet në mënyrë të arsyeshme me qëllimet e shoqërisë tregtare, me përjashtim të rasteve kur, në bazë të hetimit dhe vlerësimit të informacioneve përkatëse, veprimi ose mosveprimi është kryer në mirëbesim. Administratori është përgjegjës kundër shoqërisë ose të tretëve, si për shkelje të ligjit, ashtu edhe për shkelje të statutit ose për faje të kryera gjatë administrimit të tij. Administratori mund të heqë dorë në çdo kohë nga detyra e tij, nëpërmjet një njoftimi me shkrim drejtuar Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve. Administratori, që jep dorëheqjen, duke pasur parasysh rrethanat e veprimtarisë së shoqërisë, është gjithashtu i detyruar të thërrasë Asamblesë të Përgjithshme të Ortakëve për emërimin e administratorit të ri, përpara datës në të cilën dorëheqja të hyjë në fuqi. Nëse Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve nuk vendos emërimin e administratorit të ri në datën e përcaktuar në thirrjen e kryer nga administratori i dorëhequr, atëherë administratori i njofton me shkrim dorëheqjen Qendrës Kombëtare të Regjistrimit, së bashku me kopjen e thirrjes së mbledhjes së Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve dhe Qendra Kombëtare e Regjistrimit regjistron largimin e administratorit, sipas procedurave të ligjit Nr. 9723, datë 03.05.2007, "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit", të ndryshuar. Dorëheqja e administratorit nuk cenon paditë e shoqërisë për shkelje të detyrimit të besnikërisë që administratori ka ndaj saj, sipas këtij ligji. Emërimi i administratorit/rëve të ri/rinjë, hyn në fuqi në datën e përcaktuar sipas aktit të emërimit, u kundrejtohet palëve të treta sipas përcaktimeve të nenit 12 të ligjit Nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" i ndryshuar.

## NENI 11 PËRFAQËSIMI I SHOQËRISË

Kufizimet e tagrave të përfaqësimit të administratorit/ëve i kundrejtohen palëve të treta, në përputhje me dispozitat e nenit 12 të ligji Nr. 9901, date 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqërisë tregtare” i ndryshuar. Administratori, që përfaqësonjë bashkërisht shoqërinë tregtare, mund të autorizojnë disa prej tyre për kryerjen e disa veprimeve të caktuara apo për kryerjen e disa kategorive të caktuara veprimesh. Përfaqësimi ligjor i shoqërisë (i drejteperdrejte ose i deleguar me autorizim) është i vlefshëm për çdo veprim gjyqësor apo jashtëgjyqësor. Veprimet e kryera nga përfaqësuesi ligjor i shoqërisë (i drejteperdrejte ose i deleguar me autorizim) janë të detyrueshme për shoqërinë edhe nëse këto tejkalojnë objektin e saj, me përjashtim të rastit kur këto veprime shkojnë përtej tagrave të përfaqësimit që u jep ligji apo lejon t'u jepen përfaqësuesve. Këto veprime nuk janë detyruese për shoqërinë nëse shoqëria provon se i treti ka pasur dijeni se akti tejkalon objektin e saj, apo në bazë të rrethanave të qarta nuk mund të mos kishte pasur dijeni për të. Publikimi nëpërmjet ndryshimit të statutit nuk përbën provë të mjaftueshme për dijeninë e të tretëve, nëse ky ndryshim është bërë publik në mënyrë të ndryshme nga ato të parashikuara nga ligji për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit. Njoftimet e drejtuara secilit prej administratorëve janë të vlefshme e detyruese për shoqërinë. Tagrat e përfaqësimit të administratorëve dhe çdo ndryshim i tyre njoftohen për regjistrim pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit. Të gjitha shkresat, formularët e urdhrave apo çdo dokument tjetër korrespondencë, nxjerrë nga shoqëria, degët apo zyrat e përfaqësimit, nëpërmjet përdorimit të letrës ose mjeteve elektronike, të cilat u drejtohen palëve të treta, duhet të përmbajnë të dhënat e mëposhtme: numrin unik të identifikimit; formën ligjore të shoqërisë; vendndodhjen e selisë së regjistruar dhe të zyrës qendrore të saj; të dhëna nëse shoqëria është në likuidim; Nëse shoqëria ka faqe interneti, këto të dhëna duhet të pasqyrohen aty.

## NENI 12

Cdo gjë që tjetër dhe/ose më e detajuar parashikohet në statutin e shoqërisë, dhe/ose në legjislacionin shqiptarë në fuqi për këtë qëllim, kopje e të cilit do të depozitohet në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit (Q.K.R) / Biznesit (Q.K.B) me qëllim jo vetëm regjistrimi. Për çdo mosmarrëveshje midis ortakëve do të zgjidhet me mirëkuptim në të kundërt secili prej tyre do ti drejtohet Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë për zgjidhjen e tyre.

## THEMELUESIT E SHOQËRISË “WINWINDEAL” SH.P.K.

Eljo ELEZI

Anel KËNDEZI

Ervis KULLA